

THIRJE PËR PUNIME SHKENCORE - “THE HERITAGE”

Ju njoftojmë nga redaksia e revistës shkencore "The Heritage" – botim i UNS-së dhe Institutit për Evropianistike dhe Politikë ndërkombëtare (IPES-Institute of International Politics and European Studies) se ka filluar procedura e grumbullimit të artikujve shkencor për **numrin 28**.

E veçanta e revistës tonë është se dallohemi si një revistë hulumtuese e shkencore duke konsideruar faktin se duhen promovuar vlera të reja duke e kapërcyer veten, familjen, interesin e ngushtë dhe duke i dhënë përparësi shkencës dhe dijes. Revista “The Heritage” mbetet dritare e hapur për të gjithë ata që duan të kontribuojnë nëpërmjet studimeve të tyre dhe t’i japin një impakt tjetër shoqërisë. Ftojme studiues të shkencave ekonomike, juridike, politike, teknologjisë informative, edukimit, sferës së ekologjisë dhe sferave tjera shkencore për t’ju pergjigjur thirrjes deri në datën **22 dhjetor 2024**.

Kriteret e revistës

Çdo material që botohet në revistën shkencore “The Heritage” duhet të përputhet me standardin e gjuhës shqipe, maqedonase ose angleze. I gjithë dorëshkrimi, duke përfshirë abstraktin, listën e referencave dhe çdo lloj tabele, duhet të jetë në madhësi A4 me një hapësinë në mes (1.5), me font 12 Times New Roman. Punimi duhet të fillojë me faqen hyrëse, që përfshin titullin e punimit, emrin (emrat) e autorit (autorëve), lidhjen me institucionet dhe adresat e korrespondencës, e-mail adresën, titulli i shkurtër i sugjeruar dhe tri deri pesë fjalë kryesore. Në faqen tjetër, duhet vendosur titulli i artikullit dhe abstrakti, pastaj duhet vazhduar me përmbajtjen e artikullit. Punimi duhet të variojë nga 6-10 faqe kompjuterike. Artikulli mund të shoqërohet edhe me shënime në fund të faqes (footnotes) ose në fund të tekstit (endnotes), por në çdo rast, referencat janë të detyrueshme. Autorët lutem të mos përdorin figura. Në qoftë se ka ndonjë arsye të fortë për të pasur figura, autorët doemos duhet ta dorëzojnë një kopje elektronike origjinale në EPS, TIF, ose format JPG me rezolucion të lartë. Në qoftë se ka tabela, ato duhet të jenë të krijuara në Word dhe jo në Excel.

Abstrakti duhet dërguar/dorëzuar në gjuhën angleze, pavarësisht gjuhës së punimit shkencor, që ka zgjedhur kandidati.

Varianti elektronik i çdo numri të revistës publikohet në faqet zyrtare të Universitetit Ndërkombëtar të Strugës (iust.edu.mk ose <http://iust.edu.mk/Heritage/>).

Ju lutemi kontributorve që ti kryejnë pagesat sepse nuk do të mund tu publikohet punimi dhe fletpagesën e skenuar ta dërgojnë në financial@eust.edu.mk dhe në theheritage@eust.edu.mk

Të dhënat për pagesën

1. Pagesa për artikull është 100 euro.
2. Për pagesat jashtë Republikës së Maqedonisë shërben numri i llogarisë Swift, i cili ndodhet mëposhtë me qëllimin: " Pagesë për Heritage ".

For submitted papers by candidates outside of Republic of North Macedonia	For submitted papers by candidates from Republic of North Macedonia
IBAN: mk07240230001908444 SWIFT: uibmmk22 Universal Investment Bank AD Skopje Maksim Gorki 6, R.Macedonia Beneficiary name: MEGUNARODEN UNIVERZITET vo Struga Beneficiary address: Struga, Ezerski Lozja 1	UNI BANK AD SKOPJE, account number: 240230001908444 On behalf of IUS-Struga